

10 Qershor 2022

**Dialog, advokim dhe lobim për
parandalimin e djegies me zjarr të tokave
bujqësore, përmes përmirësimeve ligjore**

Dokument per diskutim me grupet e interesit

Pergaditur nga: PSEDA-ILIRIA

Permbajtje e dokumentit

I.	HYRJE.....	2
II.	KONTEKSTI I PROBLEMIT.....	2
III.	PRAKTIKA TË MIRA LIGJORE.....	5
3.1.	Gjermania.....	5
3.2.	Serbia	5
3.3.	Maqedonia	5
3.4.	Faktore te tjere kufizues te djegies se mbeturinave bujqesore nga vende te ndryshme	6
IV.	LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR	6
V.	LEGJISLACIONI SHQIPTAR.....	7
5.1.	Ligji 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”	7
5.2.	Ligji “Për pyjet”, nr 57/2020	8
5.3.	Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar	10
5.4.	Ligji Nr.9244, datë 17.6.2004 PËR MBROJTJEN E TOKËS BUJQËSORE	10
5.5.	VKM nr. 1080, datë 22.12.2010	10
5.6.	Urdhër i Kryeinspektorit të ISHMPUT	11
VI.	KONKLUZIONE & REKOMANDIME DHE ÇËSHTJE QË NGRIHEN PËR DISKUTIM	11
6.1.	Konkluzione dhe rekomandime paraprake.....	11
6.2.	Çështje të tjera që ngrihen për diskutim	12
ANEKSI 1.....		14
ANEKSI 2.....		16

I. HYRJE

Një ndër problemet më të rëndësishme dhe më të mëdha mjedisore por edhe ekonomike më të cilat ndeshet sot Shqipëria janë zjarret. Përveçse zjarreve masive në pyje, po përhapet gjithnjë e më shumë edhe fenomeni i djegies së tokave bujqësore, pemëtoreve, vreshtave dhe kullotave.

Procesi i djegies në rastin e tokave bujqësore përbën një problem të shumëfishtë. Përveç efektit shkatërrues në mjedis, zjarret kanë dale shpeshherë jashtë kontrolli duke djegur banesa, tokat te tjera por duke shkaktuar edhe humbje jete njerëzore.

Për të diskutuar mbi këto çështje, shoqata ILIRIA, në kuadër të projektit IdeAL po organizon diskutime dhe tryeza debati publik për “Dialogimin dhe Identifikimin e sfidave dhe mundësive për ndalimin e djegies me zjarr të tokave bujqësore” me aktorë të ndryshëm vendorë në qarqet; Shkodër, Lezhë, Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Fier si dhe institucione te tjera qendrore e lokale.

Debatet dhe diskutimet janë fokusuar rreth situatave ekzistuese që vendi ynë ka kaluar së fundmi lidhur me këtë fenomen, një vlerësim të kuadrit ligjor për djegien e tokave me zjarr dhe nxitja e grupeve të interesit në dheninen e propozimeve për reduktimin dhe eliminimin e këtij problemi kombëtar.

Ky process po zhvillohet në kuadër të projekt IdeAL, “Dialog për zhvillim politikash gjithëpërfshirëse në Shqipëri-ideAL”, projekti i zbatuar nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit dhe Qendra e Politikave Evropiane (EPC, Belgjikë) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

II. KONTEKSTI I PROBLEMIT

Përdorimi i zjarrit në bujqësi dhe pylltari (veçanërisht në bujqësi) ka rrënjë të gjata historike dhe është pjesë e bujqësisë dhe blegtorisë tradicionale një nga praktikatat më të vjetra në Evropë dhe në mbarë botën.

Kjo praktikë tradicionale kundërshtohet nga shumë specialistë. Ekspertë të fushës pas kërkimeve të gjata kanë dalë në përfundime për efektet e dëmshme të djegies së tokave, të korrave, etj. Sipas studimeve të ndryshme, diegia e tokës raportohet se ndryshon vlerat e pH të tokës, prish strukturën dhe teksturën e sajë, shkatërron lëndët organike dhe lëndët ushqyese duke ulur ndjeshëm pjellorinë dhe produktivitetin e tokës. Ndërsa është e ditur se lënda organike e tokës është një rezervuar për lëndët ushqyese të bimëve, rrit kapacitetin mbajtës të ujit, mbron strukturën e tokës kundër ngjeshjes dhe erozionit, dhe në këtë mënyrë përcakton produktivitetin e tokës. Një tjetër efekt që gjenerohet nga diegia e tokave është edhe emetimi i gazeve serrë në atmosferë (kryesisht CO₂).

Kërkime të tjera kanë treguar se diegia e përsëritur dhe afatgjatë e kashtës ose barit (kullotave) mund të ketë një efekt negativ më të përhershëm në cilësinë e tokës dhe shëndetin e

përgjithshëm të tokës. Djegia e përsëritur mund të shkaktojë ulje afatgjatë të rendimentit, e cila nuk mund të kompensohet me shtimin e pleherimit artificial (plehra kimike).


Pervecse demeve ekologjike qe shkakton zjarri, ne Shqiperi verehet situatë shume shqetesuese lidhur me sezonin kur me se shumti ndodh ky fenomen. Djegia massive e tokave verehet kryesisht ne sezonin e veres. Pikerisht atehere kur fluksi turistik eshte ne maksimum, duke dhene keshtu nje shfaqje te shemtuar, duke percjelle pasiguri por mbi te gjitha duke dhene imazhin e nje vendi i cili nuk ka asnje lloj kontrolli mbi territorin.

Sezoni i veres eshte gjithashtu edhe sezoni me i veshtire per te kontrolluar zjarre te tilla, per shkak te temperaturave te larta dhe lendes se thate organike qe digjet.

Ka patur me dhjetra raste ku zjarret kane dale jashte kontrolli duke djegur banesa, toka, prona, ullishte, pemtore etj. por edhe raste te humbjeve te jeteve njerezore.

Ajo që është edhe më shqetëuese është se djegia e tokave është një nga arsyt kryesore të shfaqjes së zjarreve në pyje, pothuajse kudo në botë. Sipas Vlerësimit Global të Burimeve Pyjore 2005 – Raport mbi zjarret në Rajonin e Mesdheut, përqindja e zjarreve në pyjeve të shkaktuara nga diegia e kullotave dhe tokave bujqësore varion nga 20 në 40%.

Per ta ilustruar kete, po japim dy grafike me te dhena te siperfaqeve te djegura ne Shqiperi per periudhen 2007-2020, te dhena nga Sistemi Evropian i Informacioneve mbi Zjarret ne Pyje (EFFIS)¹;



¹ <https://effis.jrc.ec.europa.eu/reports-and-publications/annual-fire-reports/>



Nga grafiket rezultin se pergjate periudhes 2007-2020 ne Shqiperi jane djegur 356,915 ha pyje (ose 35% e siperfaqes se pergjithshme te pyjeve ne Shqiperi) dhe 18,027 ha toka bujqesore (vreshta, pemtore, toka bujqesore) ose 2.6% e siperfaqes se fondit te tokes bujqesore te vendit.

Për të gjitha arsyet më sipër rezulton se nga një anë kemi një praktikë tradicionale e cila është thuajse e pamundur ta eliminosh dhe nga ana tjetër lind domosdoshmëria për ta disiplinuar këtë praktikë me efekte shume negative ne mjedis, prona dhe imazhin e vendit.

Në këtë kontekst sfida për ligjvënësin është të ofrojë një zgjidhje për të bërë të mundur bashkëjetesën mes traditës dhe rregullimit ligjor. Në vendin tonë rregulla për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri parashikohen në një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore në fuqi, të cilat nuk kanë qenë efektive dhe kjo duket nga numri i lartë i zjarreve në pyjet dhe kulloatat në vend.

Ky dokument ka në fokus përmirësimin e kësaj pjese të legjislacionit. Për këtë qëllim së pari është evidentuar ajo pjesë e legjislacionit që i korespondon rregullimeve ligjore në mbrojtje të pyjeve dhe tokave nga zjarret. Në një pamje sipërfaqësore vihet re se janë disa ligje të fushave të ndryshme që plotësojnë këtë kuadër ligjor, si ai për zjarret, ligji për pyjet, ligji për mbrojtjen civile, ligji për fondin kullësor. Gjithashtu vihet re se mungon një akt nënligjor me fuqi të plotë juridike, që të rregullojë posaçërisht djegien e kontrolluar të kullotave dhe të korrave (në tokat bujqësore), kriteret e lejimit të këtij procesi, rregullave para, gjatë dhe pas kësaj procedure.

Me qëllim plotësimin e legjislacionit, si fillim janë shqyrtuar ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë çështje. Mes kësaj analize janë evidentuar organet e ngarkuara nga ligji me ruajtjen e pyjeve nga zjarri, janë evidentuar vakumet ligjore dhe dispozitat e ligjit që autorizojnë krijimin e një akti nënligjor që të rregullojë në mënyrë të posacme ruajtjen e pyjeve nga zjarri dhe disiplinimin e zajrrëvënies në toka bujqësore dhe kullota dhe pyje. Në përfundim është hartuar edhe projekt akti në fjalë.

Për këtë më parë janë studiuar disa legjislacione në Evropë dhe rajon, është parë legjislacioni ndërkombëtar që adreson edhe këtë problem, edhe pse jo në mënyrë të posacme, por shpesh herë në mënyrë indirekte.

III. PRAKTIKA TË MIRA LIGJORE

Ka disa modele të rregullimit ligjor dhe që mund të konsiderohen si praktika të mira lidhur me kufizimin, parandalimin apo ndalimin e djegies së tokave bujqësore apo kategorive të tjera të tokës.

3.1. Gjermania

Në Gjermani, si anëtare e BE-së, përdorimi i zjarrit për djegien e mbeturinave në pyll është e ndaluar. Por duke marrë parasysh praktikën shumëshekullore të përdorimit të zjarrit në bujqësi, në nivel vendor, me leje të posaçme dhe kushte të veçanta të përcaktuara, lejohet djegia e kashtës dhe mbeturinave në ara, vreshta dhe pemishte. Për shkak të kontrollit të rreptë në terren dhe respektim të dispozitave ligjore, kjo metodë jep rezultate të mira. Por duhet thënë se kjo aplikohet në sipërfaqe shumë të vogla.

Ashtu si në Gjermani, djegia e fushave dhe kullotave bujqësore në Greqi, Spanjë apo Portugali është e ndaluar. Por, bujqësia dhe fermerët ende praktikojnë djegien tradicionale të kashtës dhe kullotave. Si rrjedhojë, përqindja e zjarreve në pyje të shkaktuara prej tyre është e madhe.

Siç u tha tashmë, shtetet anëtare të BE-së i përshkruajnë këto masa në përputhje me rregulloren e KE-së nr 1259/1999, Protokollet e Kiotos dhe të tjera të ngjashme.

Në vende të tjera jashtë BE gjithashtu djegia e tokave është e ndaluar përveçse kur miratohet me një leje dhe në kushte të veçanta. Kufizimi i djegies në legjislacione të ndryshme varet nga përvojat e përdorimit të zjarreve në të tashmen dhe të shkuarën.

3.2. Serbia

Ky problem në Serbi është i rregulluar në ligjin për pyjet dhe ligjin për tokën bujqësore. Në këtë rast, nuk lejohet që të ndizet zjarr në një distancë më të vogël se 200 m nga buza e pyllit. Përfundimisht bëjnë ndezja e zjarrit në pyll ose tokë pyjore, në një vend që është caktuar për atë qëllim, në mënyrë të duhur dhe të shënuara qartë me zbatimin e masave.

Edhe djegia e tokave bujqësore ka përbërë një problem madhor atje, por tashmë është kufizuar duke i dhënë zgjidhje teknike, ekonomike dhe ligjore problemit.

3.3. Maqedonia

Në Maqedoni, si në shumë vende të tjera, rregulloret ligjore janë në përputhje me konventat ekzistuese, protokollet, etj., por problemi me përdorimin e zjarrit si mjet në bujqësi dhe pylltari nuk është zgjidhur në mënyrë të kënaqshme. Këto janë veçanërisht të konsiderueshme për praktikën e djegies së tokave bujqësore dhe kullotave. Rreth 20-30% e zjarreve në pyje vijnë nga pakujdesia e ndezjes së tokave bujqësore dhe kullotave.

Arsyeja kryesore për këtë është moszbatimi i ligjeve në praktikë, politika e dobët penale dhe niveli i ulët i vetëdijes së bujqësisë dhe fermerëve për rreziqet dhe pasojat negative nga përdorimi i zjarrit. Duke i përmbledhur të gjitha këto fakte, mund të konkludojmë disa gjëra:

1. Arsyetimi për ndalimin total ose mënyrën e përcaktuar rreptësisht të përdorimit të zjarrit në bujqësi dhe pylltari është i pamohueshëm.
2. Konventat ndërkombëtare, direktivat etj., si dhe legjislacioni kombëtar (në Evropë) e rregullojnë plotësisht këtë çështje.
3. Problemi kryesor janë mekanizmat e dobët (në shumicën e vendeve evropiane) për kontroll dhe sanksionet për shkeljen e këtyre ligjeve. Kjo vjen nga fakti se shkelësit nuk e bëjnë këtë me qëllim për të shkelur ligjin dhe për të patur një përfitim ekonomik, por kryesisht nxitet nga tradita më e lashtë e përdorimit të zjarrit si mjet në bujqësi. Një arsye tjetër për këtë është ndërgjegjësimi i ulët i kësaj kategorie njerëzish për efektet e dëmshme të kësaj praktike.
4. Zgjidhja e këtij problemi është e mundur vetëm përmes një qasjeje të integruar. Krahas legjislacionit të mirë ekzistues, duhet punuar në mekanizmat e kontrollit, por shumë më tepër në edukimin dhe ndërgjegjësimin e popullatës rurale. Prandaj, duhet të punohet në rregulloret dhe kushtet në të cilat lejet parashikojnë përdorimin e zjarrit në bujqësi, blegtori dhe pylltari.

3.4. Faktore të tjera kufizues të djegies së mbeturinave bujqesore nga vende të ndryshme

Vende të ndryshme kanë vendosur rregulla strikte lidhur me këto probleme duke e ndaluar teresisht ose kufizuar në;

- Koheshtrirje (psh djegia lejohet vetëm gjatë periudhës 31 Tetor deri 1 Mars)
- Shpejtesinë e erës (psh ndalohet djegia e mbeturinave nëse shpejtesia e erës është mbi 30 km/ore)
- Distancën (psh jo më afër se 300 metra nga karburantet apo depozitat e karburanteve, 200 metra nga qendrat e banuara apo 100 metra larg shtepisë me të afert etj. etj.)
- Vendin ku ndodh djegia (psh jo më afër se 100 metra nga rruget nacionale)
- Koha – djegia duhet bërë vetëm gjatë periudhës së ditës
- Koha – djegia vetëm në fundjavë, gjatë periudhës së ftohtë (dimer)
- Kontrolli i zjarrit (psh gjatë kohës së djegies, së paku 2 persona duhet të jenë prezent gjithë kohën aty)
- Njoftimi i autoriteteve (duhen njoftuar së paku 48 orë përpara procesit të djegies duhen njoftuar psh bashkia, emergjencat civile, policia etj)
- Kufizime në sipërfaqe (psh. jo më shumë se 2000 m²)

Vende të ndryshme evropiane i kanë pershtatur ligjet/udhëzimet/rregulloret për ndalimin/kufizimin e djegies së mbeturinave të tilla në ligjet e pyjeve, kullotave, mbrojtjes nga zjarri, menaxhimit të mbetjeve, bujqesisë etj.

IV. LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR

Kërcënimet kryesore ndaj biodiversitetit janë: zhvillimi industrial, urbanizimi, gjuetia ilegale, peshkimi, erozioni i tokës, energjia dhe minierat, transporti dhe turizmi, sektorë këto që kanë ndikim në shumëllojshmërinë biologjike. Faktorët kryesorë të humbjes së biodiversitetit janë aktivitetet antropogjene ku shpyllëzimi dhe shkretëtirëzimi i tokës së punëshme, aq sa shkatërrimi i livadheve dhe kullotave, kanë pasur një ndikim të madh në ndryshimet e habitateve në të kaluarën e afërt. Ndërtimi i rrugëve dhe ndryshimet në rrjedhën e ujit ose ndërtimi i digave, ndërtimi i tubacioneve, ndotja që vjen nga origjina të ndryshme, zjarret, sëmundjet dhe ndryshimet klimatike janë dhe do të jenë arsyt e degradimit dhe fragmentimit të habitateve në Shqipëri.

Duke marrë parasysh të gjitha këto sipas Rregullores së KE 1259/1999 *diegia e kullotave dhe tokës bujqësore në vendet e BE-së është e ndaluar*, përveç nëse lejohet nga autoritetet kompetente për arsye shëndetësore të bimëve.

Dokumente të tjerë ndërkombëtarë, të cilët kanë ndikim parimor mbi çështjen që tratojmë janë edhe:

- Konventa e Bernës (Bern, 1979) (ratifikuar nga parlamenti i Shqipërisë me Ligjin nr. 8294, date 2.3.1998) Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror evropian. Objektiva kryesore është ruajtja e florës dhe faunës së egër dhe habitateve natyrore.
- Kodi i Praktikës së Mirë Bujqësore për Parandalimin e Ndotjes së Ujit, Ajrit dhe Tokës në Strategjinë Tematike Evropiane për mbrojtjen e tokës (2006).

V. LEGJISLACIONI SHQIPTAR

5.1. Ligji 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”

Ligji 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” është ligji kuadër që rregullon fushën e zjarrvënies”, në nenin 2 të këtij ligji parashikohet misioni i këtij ligji ku:

“Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në vijim shërbimi i MZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.”

Më tej në nenin 8 parashikohen kompetencat e ministrit të mbrojtjes, ku janë vecuar ato kompetenca që i shërbejnë mbrojtjes së pyjeve nga zjarri, konkretisht:

- “a) përcakton objektivat për zbatimin e politikave të përgjithshme dhe të programit të qeverisë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin;*
 - b) orienton zbatimin e politikave të veprimtarisë së shërbimit të MZSH-së, me qëllim rritjen dhe garantimin e sigurisë publike nga zjarri dhe shpëtimin shkallë vendi.*
- 2. Ministri nxjerr udhëzime, në zbatim të ligjit, për të unifikuar veprimtarinë e shërbimit të MZSH-së, të cilat janë të detyrueshme për çdo bashki, institucion, subjekt privat apo shtetëror.”*

Kompetenca më të zgjeruara në këtë fushë ka Kryetari i bashkisë, ku sipas nenit 9 të ligjit janë:

- gj) planifikon fonde për trajnimin, kualifikimin periodik dhe rritjen e aftësive profesionale të personelit zjarrfikës që ka në juridiksion;*
- h) siguron, nëpërmjet mjeteve të informimit publik që ka në dispozicion, informimin për edukimin e komunitetit me njohuritë dhe masat e mbrojtjes kundër zjarrit;*

Ndërsa detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, përcaktohen në nenin 10 si më poshtë:

- “a) harton rregullore për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me standardet ndërkombëtare në fuqi, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;*
- b) harton dhe unifikon metodologjinë për masat e parandalimit, ndërhyrjes dhe inspektimit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;*
- c) bashkëpunon me kryetarin e bashkisë për zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore;*
-”*

Në nenin 13 përcaktohen kompetencat e shërbimit vullnetar të MZSH-së:

- “1. Në bashki krijohet shërbimi vullnetar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me këtë ligj, dhe ai bëhet pjesë e shërbimit të MZSH-së në nivel vendor.*
- 2. Struktura, uniforma dhe shenjat dalluese të veçanta, të punonjësit të shërbimit vullnetar të MZSH-së, miratohen me vendim të këshillit bashkiak.”*

Të drejtat dhe detyrat e shërbimit të MZSH-së, parashikohen në nenin 48, ku përcaktohet se:

- “....*
- g) njofton, rregullisht, publikun për detyrat dhe masat në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, për rreziqet që vijnë në rast zjarresh, fatkeqësish natyrore, teknologjike, si dhe për mënyrën e dhënies së ndihmës në këto raste, përmes formave të ndryshme të informimit.”*

5.2. Ligji “Për pyjet”, nr 57/2020

Sic sugjerohet edhe nga titulli, ky ligj rregullon kompetencat dhe rregullat për administrimin për pyjet. Sipas këtij ligji, në nenin 12 të tij përcaktohet se “...kriteret dhe rregullat për dhënien në përdorim të fondit pyjor përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave”

Në nenin 25 rregullohet shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar. Sipas këtij neni:

- “ Pjesë të fondit pyjor publik jepen në shfrytëzim/përdorim për zhvillimin e veprimtarive Rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për këto veprimtari caktohen me udhëzim të ministrit.”*

Në nenin 30, pika 3 përcaktohet se: “Ndalohej ndezja e zjarreve në fondin pyjor kombëtar, publik apo privat, në tokat e tjera në afërsi të tyre, si dhe çdo veprim tjetër që përbën burim ose shkak për përhapjen e pakontrolluar të tyre.”

Ndërsa në pikën 4 në vijim parashikohen masa për parandalimin e zjarreve në fondin pyjor kombëtar, ku konkretisht:

a) strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki/zona të mbrojtura, si dhe pronarët privatë organizojnë sistemin e vrojtimit-sinjalizimit duke zbatuar të gjitha detyrimet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile dhe për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

b) struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, si dhe pronarët privatë, çdo vit hartojnë planin për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar në territorin e tyre, ku përfshihen mjetet në dispozicion, si dhe numri i personave të organizuar në njësitë e posaçme për këtë qëllim, duke koordinuar dhe zbatuar të gjitha përcaktimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe planin vendor për emergjencat civile;

c) plani për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar **miratohet nga këshilli bashkiak brenda muajit mars të çdo viti**. Bashkitë koordinojnë këtë plan me detyrimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, për të siguruar funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e tyre. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar, detyrohen sipas ligjit përkatës për mbrojtjen civile të garantojnë mbrojtjen nga zjarret në këto sipërfaqe, duke hartuar/përditësuar planet për mbrojtjen e tyre nga zjarret, të harmonizuara me planet e jashtme për emergjencat civile të bashkisë dhe prefekturës, si edhe detyrimin për rregulloret e brendshme të tyre;

ç) struktura përgjegjëse për pyjet në bashki organizon çdo vit fushata informimi, sensibilizimi dhe trajnimi për parandalimin e zjarreve në pyje. Këto fushata organizohen në nivel kombëtar edhe nga ministria dhe agjencia.

5. Për shuarjen e zjarreve në pyje:

a) njësitë e vetëqeverisjes vendore, komunitetet lokale dhe pronarët privatë ngrenë njësi të posaçme dhe bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me strukturat e tjera shtetërore sipas detyrimeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, përdoruesit e pyjeve përmes përfaqësuesve të tyre lokalë dhe pronarët privatë mbajnë të dhëna statistikore për zjarret në pyjet brenda territoreve të tyre dhe raportojnë pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet;

b) shpenzimet për shuarjen e zjarreve përballohen nga struktura ose subjekti që ka në pronësi pyllin dhe nga buxheti i shtetit në rastin e një prone me rëndësi kombëtare, historike, kulturore, arkeologjike, ekologjike etj.

6. Për masat e mbrojtjes së pyjeve nga rreziku i zjarrit zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.”

Në përfundim në pikën 9 parashikohet se “për mbrojtjen e fondit pyjor kombëtar, përcaktohen kriteret dhe rregullat për kullotjen në pyje me udhëzim të ministrit.”

Në nenin 36 të ligjit parashikohen kundravajtjet administrative ku: “Dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë... ndezja e zjarreve jashtë vendeve të caktuara apo në fondin pyjor kombëtar, publik dhe privat, në tokat e tjera në afërsi të tyre, si dhe çdo veprim tjetër që përbën burim ose shkak për përhapjen e pakontrolluar të tyre

5.3. Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar

Edhe ky ligj, rregullon administrimin e fondit kullosor ne Republikën e Shqipërisë. Në një nga dispozitat e këtij ligji, konkretisht në nenin 22 parashikohet se:

“1. Djegia e kullotave dhe livadheve nga pronari, nga përdoruesi apo nga persona të tjerë është e ndaluar dhe ndëshkohet, sipas rastit, nëse është kundërvajtje administrative, në përputhje me dispozitat e këtij ligji ose, nëse përbën vepër penale, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Penal.

Djegia e kullotës apo livadhit mund të lejohet vetëm në raste të veçanta dhe me miratimin e struktursës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, në territorin e së cilës ndodhet.”

Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, për djegien e kullotës, jep miratim me shkrim, në përputhje me udhëzimin e ministrit, ku përcaktohen rregullat dhe procedurat e këtij veprimi.

Në rast zjarri në kullota dhe livadhe, drejtoria që mbulon kullotat në ministri, bashki, pronarët privatë, Forcat e Armatosura e çdo shtetas, që ndodhet në afërsi, njoftojnë organet e mbrojtjes nga zjarri (MNZ), organet e shërbimit pyjor e të pushtetit vendor, si dhe marrin pjesë për shuarjen e tij. Shpenzimet për shuarjen e tij i ngarkohen personit që ka vënë zjarrin ose përballohen nga pronari, kur zjarri ka ndodhur për shkaqe natyrore.

5.4. Ligji Nr.9244, datë 17.6.2004 PËR MBROJTJEN E TOKËS BUJQËSORE²

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë parimet, rregullat dhe institucionet për ruajtjen dhe përmirësimin në mënyrë të qëndrueshme të funksioneve që përmbush toka bujqësore dhe, në veçanti, pjellorinë e saj dhe të ruajtje dhe të rehabilitojë tokën bujqësore nga veprimi i dëmshëm i faktorëve të ndryshëm klimatike dhe njerëzore.

Në kreun III, të emërtuar “Parandalimi i dëmtimit të tokës bujqësore”, mungon një parashikim konkret për mbrojtjen e tokës bujqësore nga vënia e zjarreve, edhe pse dihet se ky fenomen është një prej dëmtuesve të tokës bujqësore.

5.5. VKM nr. 1080, datë 22.12.2010

VKM nr. 1080, datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve”.

Ky Vendim rregullon një pjesë të mirë të problematikës së zjarrvënies në pyje, por efektshmëria dhe fuqia ligjore e këtij akti nuk është e qartë.

Së pari, ky akt nuk ka qenë efektiv. Vlen të theksohet se nga takimet me specialistët në institucionet shtetërore përgjegjëse për zjarret në pyje një pjesë e tyre nuk e njohin këtë akt gjë, e cila tregon për mungesën e efektivitetit të këtij akti.

² Ndryshuar me ligjin Nr. 69/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore"; Ligjin Nr. 131/2014 “Për një ndryshim dhe shtesë në Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar.

Së dyti, ky akt është i bazuar në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” (I ndryshuar), i cili është shfuqizuar nga ligji i ri për pyjet nr.57/2020.

Nga njëra anë, VKM-ja në fjalë është teorikisht ende në fuqi, pasi ligji i ri për pyjet dispozitat tranzitore të tij parashikon se aktet që nuk bien ndesh me këtë ligj vijnë në fuqi dhe ky akt nuk bien ndesh me këtë ligj në rastin më të keq në pjesën më të madhe të tij. Por nga ana tjetër një akt nënligjor duhet detyrimisht të autorizohet nga ligjet në fuqi, gjë e cila i mungon kësaj VKM-je dhe kjo e bën të debatueshme fuqinë ligjore të kësaj VKM-je.

Gjithashtu, kjo VKM në frymën e legjislacionit më të gjerë të ndryshuar në disa aspekte ka nevojë për tu azhornuar. Për të gjitha këto arsye rekomandohet hartimi i një akti nënligjor i ri i cili mund të marrë për bazë rregullime të vecanta të përcaktuara në këtë VKM dhe kështu adresohen problematikat e prezantuara më sipër në mënyrë më të saktë sa i takon teknikës legjislative, gjë e cila ndikon drejtpërdrejt edhe në qartësinë e rregullimit ligjor por edhe në efektshmërinë e zbatimit të një akti të ri.

5.6. Urdhër i Kryeinspektorit të ISHMPUT

Urdhër i Kryeinspektorit të ISHMPUT (Inspektoriati shtetëror i mjedisit, pyjeve ujerave dhe turizimit nr. 285, datë 20.06.2018 “Për përcaktimin e metodologjisë së raportimeve mujore dhe javore të kundërvajtjeve administrative dhe penale në fondin pyjor, kullosor, të gjuetisë, të zjarreve dhe respektimin e afateve kohore të informimit”.

Në momentin e hartimit të këtij dokumenti, hartuesit nuk disponojnë ende një kopje të këtij urdhëri, i cili është kërkuar përmes një kërkesë për informacion dhe mbetet për t’u zhvilluar në një moment të dytë.

VI. KONKLUZIONE & REKOMANDIME DHE ÇËSHTJE QË NGRIHEN PËR DISKUTIM

6.1. Konkluzione dhe rekomandime paraprake

Nga kërkime të ndryshme por edhe nga takimet me ekspertë të fushës në vend të përzgjedhur nga qytete të ndryshme të Shqipërisë pranohet se pjesa më madhe diegjes së tokave vjen për shkaqe tradicionale të praktikës bujqësore dhe blegtorale dhe tradita është e vështirë të ndryshohet vetëm me legjislacion. Në këtë kuptim përmirësimet ligjore duhet patjetër të shoqërohen me masa të tjera edukuese/ndërgjegjësuëse. Megjithatë për qëllim të këtij dokumenti ne jemi fokusuar vetëm në ndryshimet ligjore, sipas rekomandimeve në vijim.

1. Në zbatim të nenit 13 të ligjit nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, Këshilli Bashkiak i çdo njësie të qeverisjes vendore rekomandohet të krijojë sa më shpejt shërbimin vullnetar për mbrojtjen nga zjarri. Ky shërbim mund të luajë një rol aktiv në masat parandaluese, mes njoftimeve, informimit të publikut, edukimit të tij, etj.

2. Në ligjin nr 9244, datë 17.06.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, në kreun III, shtohet nenin 14/1 me përbajtjen sipas Aneksit nr 1.
3. Rekomandohet që në Vendimin e Këshillit të Ministrave që do të miratohet në zbatim të nenit 12, të ligjit nr 57/2000, “Për pyjet”, të parashikohen detyrime të posaçme për përdoruesit e fondit pyjor, për parandalimin e zjarrit. Në mënyrë alternative këto detyrime mund të jenë pjesë e Udhëzimit të Ministrit, i ngarkuar nga neni 25 i ligjit nr 57/2020, për të nxjerrë udhëzim për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të kërkimit, shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar.
4. Administrimi dhe përgjegjësia për marrjen e masave kundër djegies eventuale në kullota të jetë detyrim kontraktual, shoqëruar me penalitete në rast të shkeljes së këtij detyrimi. Subjektet që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në fondin kullor, sipas nenit 17 pika 3 të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për fondin kullor”, u nënshtrohen procedurave të konkurrimit publik, i cili organizohet nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor ose, për kullotat bashkiake, nga njësia e qeverisjes vendore. Me subjektin fitues lidhet kontrata, ku përcaktohen kërkesat dhe kushtet, që duhen zbatuar gjatë ndërtimit dhe ushtrimit të veprimtarisë. (neni 18 i ligjit). Në zbatim të nenit 30 të ligjit nr 57/2020, Ministri miraton Udhëzimin për përcaktimin e kritereve dhe rregullave për kullotjen në pyje. Rekomandohet që në këto rregullime të parashikohen detyrimi për përfshirjen e kushteve dhe penaliteteve kontraktuale për përgjegjësinë e përdoruesve të kullotave, të cilët duhet të mbajnë përgjegjësi për zjarrvëniet në kullotat në përdorimin e tyre.
5. Në zbatim të nenit 30 të ligjit nr 57/2020, Këshilli Bashkiak duhet të miratojë cdo vit brenda muajit mars, planin për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin kombëtar. Rekomandohet që në hartimin e këtij plani të ftohen të marrin pjesë edhe përdoruesit/shfrytëzuesit e fondit pyjor dhe kullor, (lehtësisht të identifikueshëm nga bashkia nga kontratat me ta). Kjo pritet të ketë dy efekte: (1) Përdoruesit e fondit pyjor/kullor mund të ndërgjegjësohen për pasojat negative të djegies së tokave dhe do tu jepet një rol aktiv në parandalimin e djegies. Në mënyrë alternative këta të fundit mund të incentivohen edhe me shpërblime monetare, për rastet e suksesit, sidomos kjo praktikë mund të sjellë rezultat në zonat me rrezikshmëri të lartë zjarrvënie, si jugu i Shqipërisë, ku raportohet se praktika e djegies së kullotave është traditë. (2) Njëkohësisht në këtë plan duhet të parashikohet edhe ngritja e njësisive të posaçme që bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe me strukturat e tjera shtetërore.
6. Pjesë e dokumenteve planifikues të territorit si në nivel vendor dhe në nivel qendror duhet të jetë ndërtimi i rrugëve të kalimit, rreth pyjeve, i cili raportohet të jetë një nga shkaqet që pamundësojnë shërbimin zjarrfikës të ndalojë përhapjen e zjarrit në një kohë të shpejtë. Ky qëllim mund të duhet të realizohet përmes një amendimi të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, duke shtuar shprehimisht këtë kriter në hartimin dhe miratimin e dokumenteve të planifikimit të territorit.
7. Mund të propozohen akte që rregullojnë në mënyrë strikte djegien e cdo lloji kategorie toke (VKM të posaçme, udhëzime apo rregullore), sipas Aneksit 2.

6.2. Çështje të tjera që ngrihen për diskutim

1. Në zbatim të nenit 8 të ligjit 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” Ministri i Brendshëm nxjerr një udhëzim për të unifikuar veprimtarinë e shërbimit të MZSH të detyrueshme për cdo njësi të qeverisjes vendore. Çfarë sugjerohet të përfshihet në këtë udhëzim? Cili aspekt ka më shumë nevojë për unifikim?
2. Në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, Drejtoria e Përgjithshme e MZSH harton rregulloren për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, e cila miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. A do ishte ky dokumenti kryesor ku të përfshihet rregullat për moratorium të djegies dhe ato të djegies së kontrolluar? A duhet të adresohen të gjitha parashikimet e VKM nr.1080, datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve”, e cila për pasojë do të shfuqizohet plotësisht?.
3. Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr 9693/2007 “Për fondin kullosor”, Ministri i Bujqësisë duhet të miratojë udhëzimin për dhënien e miratimit me shkrim të lejes për djegien e kullotës apo livadhit, ku të përcaktojë rregullat dhe procedurat e këtij veprimi. A do ishte një formulë më e saktë që ky udhëzim të mbështetej edhe mbi rregulloren e miratuar me VKM sipas pikës së mësipërme? A do duhet të vendosen në këtë dokument kriteret e lejes për djegien e kontrolluar?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9244 DATË 17.06.2004
“PËR MBROJTJESN E TOKËS BUJQËSORE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 dhe 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI**

Në ligjin nr. 9244 datë 17.06.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas nenit 14, shtohet një nen 14/a me këtë përmbajtje:

“1. Ndalohet ndezja e zjarreve në tokat bujqësore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 deri 6 të këtij neni.

2. Ndalohet djegia e kashtës apo mbetjeve të tjera bujqësore, barërave, ferrave apo shkurreve, që rrezikojnë përhapjen e zjarreve në toka bujqësore, pyje dhe kullota, gjatë periudhës nga 1 Prilli deri 30 Nentor të çdo viti.

3. Për periudhën tjetër të vitit ky proces mund të kryhet vetëm pas:

a. marrja e lejes nga njësia e qeverisjes vendore, ku specifikohen: emri i personit apo personave që merr përsipër veprimin e djegies; vendndodhja e sipërfaqes që do të digjet, datën dhe orën kur do bëhet djegia; pëlqimi me shkrim i pronarëve ose poseduesve të pronave në kufi me pronën ku do të kryhet djegia;

b. marrjes së lejes nga shërbimet e mbrojtjes civile, ku përshkruhen masat parandaluese që zjarri të mos dalë jashtë kontrollit, sipas formatit të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

4. Djegia e tokave bujqësore, vreshtave, pemtoreve, shkurreve e ferrave, referuar pikës 3 të këtij neni, në çdo rast duhet të bëhet duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

a. Djegia duhet të nisë dhe të përfundojë gjatë orëve të ditës (nga ora 08:00 - 18.00);

5. Në çdo rast ndalohet ndezja e zjarreve:

- a) në zona që shtrihen brenda territorit të zonave të mbrojtura, zonave turistike, pikave të kalimit kufitar apo zonave kufitare të Republikës së Shqipërisë;
- b) në distancë më të afërt se 100 metra nga akset rrugore kombëtare;
- c) në distancë më të afërt se 200 metra nga sipërfaqet pyjore, plantacionet me drurë të ndryshëm dhe vreshtat;
- ç) në distancë më të afërt se 300 metra nga pikat e shitjes së karburanteve apo depozitat e tyre;
- d) në distancë më të afërt se 200 metra nga fshati më i afërt dhe së paku 100 metra larg çdo banese individuale;
- dh) në ditët kur era fryn me shpetësi mbi 20 km/orë, edhe nëse janë marrë lejet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni;
- e) në një sipërfaqe më të madhe se 1000 m² brenda një dite.

6. Pavarësisht parashikimeve të mësipërme, në raste përjashtimore lejohet djegia në tokat bujqësore kur shfaqet domosdoshmëria e mbajtjes nën kontroll të sëmundjeve ose faktorëve të tjerë dëmtues, bazuar në urdhërin e posaçëm të autoritetit kompetent për marrjen e masave emergjente kundër fatkeqësive natyrore.

7. Rregulla të hollësishëm për marrjen e masave parandaluese për përhapjen e zjarreve në tokat bujqësore caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 2

Në nenin 28, pas pikës d) shtohet një pikë dh) me këtë përmbajtje:

“dh) moszbatimi, nga pronaret e tokës bujqësore dhe posedues të tjerë të ligjshëm, të kërkesave të nenit 14/a të këtij ligji, në rastet kur veprimtaria nuk përbën veprën penale të shkatërrimit të tokës, sipas përcaktimeve të nenit 23 të këtij ligj **denohet me gjobe. Vlera e gjobës, përveç vlerës së dëmit të shkaktuar nga djegia e tokës, për çdo 1 m² tokë të djegur është 1000 (njëmijë) lek.**

Neni 3

Dispozitë kalimtare

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve të nxjerrë aktin nënligjor të përcaktuar në pikën 7 të nenit 1 të këtij ligji.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
LINDITA NIKOLLA**

ANEKSI 2

DRAFT "PËR RREGULLAT PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË TOKAT BUJQËSORE DHE NE TOKA TE TJERA"

Shënim: Ky draft mund të përshtatet si:

- *Pjesë plotesuese e amendamentit ligjor të paraqitur në Aneksin 1 me sipër, si pjesë e rregullave që mund të miratohen nga Këshilli i Ministrave sipas pikës 7 të nenit 14/a.*
- *Pjesë e rregullores për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, sipas ligjit nr. 152/2015, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave, ose;*
- *Pjesë të caktuara mund të përshtaten për përfshirje në udhëzimin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit sipas ligjit nr. 9693/2007 "Për fondin kullosor", ose;*

1. Për parandalimin dhe zbulimin në kohë të rreziqeve nga zjarret në toka bujqësore apo çfarëdo lloji kategorie tjetër tokash (përfshire kullotat), si dhe për shuarjen e tyre, Shërbimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në njësitë e qeverisjes vendore ka këto detyra:

a) Harton planet e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje, kullota dhe toka bujqësore, në pronësi private apo në administrim të qeverisjes vendore, në përputhje me planin e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve, të miratuar nga Këshilli Bashkiak, dhe me udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH. Në këto plane të jepen në mënyrë të hollësishme masat e veprimet e domosdoshme për parandalimin e rreziqeve nga zjarri, veprimet për zbulimin e shuarjen e zjarreve dhe për rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara nga zjarri.

b) Organizon një sistem të vrojtimit-sinjalizimit, i cili funksionon gjatë gjithë vitit në shkallë të ndryshme gatishmërie, në varësi të sezonit të zjarreve.

c) Organizon, për shuarjen e zjarreve dhe eliminimin e pasojave të tyre, njësitë vullnetare të shuarjes së zjarreve (NJVSHZ) të përcaktuara me vendim të Këshillit Bashkiak, të cilët veprojnë gjatë periudhës 1 maj - 15 tetor, për të gjithë kategoritë e tokave në pronësi apo administrim të qeverisjes vendore.

ç) Planifikon pajisjen, shpërndarjen dhe përdorimin efektiv të burimeve njerëzore e të materialeve që ka në dispozicion.

d) Drejton fushata për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për rrezikun e zjarreve dhe mbrojtjen nga zjarri.

dh) Në bashkëpunim me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH, organizon trajnimin dhe kualifikimin e punonjësve të NJVSHZ-ve, për shuarjen e zjarreve.

2. Njësitë e qeverisjes vendore miratojnë planin e masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor e kullësor vendor, dhe në tokat bujqësore për të gjitha format e pronësisë dhe/ose të përdorimit për njësinë e qeverisjes vendore, duke marrë më parë vlerësimin e Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH.

3. Djegia e materialeve me mbermbajtje organike në toke (kashta, mbetje nga të korrat, bime të tjera jo të dobishme) lejohet vetëm me leje të posaçme nga organet e pushtetit vendor.

4. Njësitë e qeverisjes vendore miratojnë formatin e lejes ku specifikohen: emri i personit apo personave që merr përsipër veprimin e djegies; vendndodhja e sipërfaqes që do të digjet, datën dhe orën kur do bëhet djegia; pëlqimi me shkrim i pronarëve ose poseduesve të pronave në kufi me pronën ku do të kryhet djegia.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit miraton formatin e lejes nga shërbimet e mbrojtjes nga zjarri, ku përshkruhen masat parandaluese që zjarri të mos dalë jashtë kontrollit.

6. Për parandalimin e zjarreve, Shërbimi i MZSH kryen veprimet e mëposhtme:

a) Ndalojnë në largësi 200-300 metra ndezjen e zjarreve në toka bujqësore, pyje e kullota ose jashtë tyre, që rrezikon djegien e sipërfaqeve të tjera aty;

b) Ndalojnë tymosjen e bletëve, përveçse kur ky veprim kryhet me mjete që kanë pajisje të posaçme dhe kapak plotësisht të mbyllur;

c) Mbajnë nën kontroll vizitorët, ekskursionistët, grupet sportive, gjatë vizitave të tyre në natyrë apo zona ku prania e zjarrit paraqet problem serioz për shëndetin dhe mjedisin.

ç) Ndalojnë përdorimin e tapave të fishekëve të gjahut prej materiali që merr zjarr lehtë (lini, letër, pece etj.);

d) Ndalojnë djegien e kashtës së të korrave të kulturave bujqësore që rrezikojnë përhapjen e zjarreve në pyje dhe kullota, gjatë periudhës nga 1 Mars deri 30 Nëntor, si dhe ndalojnë këtë proces për periudha të tjera të vitit pa marrjen e lejes nga njësitë e qeverisjes vendore;

dh) Kërkojnë ndalimin e qitjeve me predha që shkaktojnë zjarr në zonat me drurë pyjorë të thatë dhe mbeturina pyjore (gjethe, shkarpa, dege etj.) e në kullota;

e) Vendosin në udhëkryqe e vende të dukshme tabela me shënime për mbrojtjen nga zjarri;

ë) Mbajnë në gatishmëri sistemin e lajmërimit dhe mjetet e komunikimit;

f) Organizojnë prova gatishmërie për të verifikuar skemat e lajmërimit, grumbullimin e njerëzve, gatishmërinë e mjeteve e të sistemeve të ndërlidhjes e të komunikimit.

7. Për pyjet komunale dhe për pyjet private, masat parandaluese zbatohen nga njësitë e qeverisjes vendore e pronarët privatë, në përputhje me kërkesat e planit, të miratuara nga njësitë e qeverisjes vendore.

8. Pronarët ose përdoruesit privatë ngrenë infrastrukturën për mbrojtjen nga zjarri dhe kontrollohen nga Inspektoriati për Mbrojtjen e Territorit për zbatimin e masave parandaluese e të masave për ndërhyrje në raste zjarresh.

9. Nën linjat e tensionit të lartë që kalojnë në pyje dhe kullota, krijohet një trase me gjerësi 20-30 metra, e cila pastrohet vazhdimisht nga drurët dhe mbulesa vegjetative, për të shmangur zjarret dhe aksidentet e mundshme nga defektet dhe këputjet e linjave. Punimet për hapjen dhe mirëmbajtjen e traseve bëhen në bazë të një projekti teknik, që hartohet dhe miratohet nga njësia e qeverisjes vendore përkatëse, e cila ndjek edhe zbatimin e projektit. Shpenzimet dhe përgjegjësinë për kryerjen e këtij operacioni i ka operatori i sistemit të transmetimit ose administruesi i linjës.

10. Në anët e rrugëve kombëtare që kalojnë nëper toka bujqesore, pyje e kullota, ndërmarrjet e mirëmbajtjes së rrugëve pastrojnë skarpatet e rrugëve nga vegjetacioni, me qëllim parandalimin e zjarreve.

11. Ndezja e zjarreve në zonat e mbrojtura mjedisore, pyje, kullota dhe ne toka te tjera bëhet vetëm në zona të përcaktuara nga pronaret/menaxheret ose administruesit e atyre tokave, pasi të jenë marrë masat e nevojshme për krijimin e kushteve të përshtatshme që parandalojnë përhapjen e zjarrit.

12. Gjatë operacioneve të parandalimit e të shuarjes së zjarreve, në të cilat ka banesa ose objekte të tjera civile, njësitë e qeverisjes vendore, personat fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë bashkëveprojnë me Shërbimin e MZSH, duke shkëmbyer informacione dhe burime njerëzore e materiale, sipas nevojave respektive dhe mundësive reale.

13. Nëpunës të qeverisë vendore dhe qendrore, në cdo rast të konstatimit të zjarrit në cfarëdolloj kategorie toke, njoftojnë shërbimet e MZSH, policinë si dhe institucionet që janë përgjegjëse për menaxhimin/administrimin e kategorisë së tokës që është duke u djegur.

14. Rastet kur ndezja e zjarreve është e lejuar, duhet që të plotesohen disa kushte minimale të tilla si;

- a. Distanca minimale nga rruga automobilistike të jete 150 metra
- b. Nje brez mbrojtës përreth sipërfaqes që digjet me gjerësi 10 metra
- c. Të pakten 5000 litra ujë depozite në dispozicion
- d. Nje mjet me pajisje zjarrfikese në dispozicion, në afërsi të tokës ku do bëhet djegia
- e. Plani i emergjencës në rast se zjarri del nga kontrolli
- f. Personi të jete në moshe më të lartë (mbi 18 vjet)
- g. Hiri që rezulton nga djegia duhet futur në tokë brenda 24 orëve
- h. Leje nga bashkia, drejtoria e Bujqësisë, AKM dhe AKZM
- i. Periudha e lejuar; 1 Dhjetor-28 Shkurt
- j. Koha – djegia fillon pasi të ketë dale dielli dhe përfundon përpara përdimit të tij
- k. Në tokat torfike – ndalohej djegia
- l. Sipërfaqja që do digjet – jo më shumë se 0.5 ha
- m. Djegia nuk do të lejohet në raste se shpejtësia e erës është më e madhe se 20 km/ore.
- n. Në cdo rast, ndalohej djegia e;
 - Gomave
 - Plastikave
 - Mbetjet nga prishja e ndërtimeve

- Mbetjet shtëpiake
- Bojërave
- Mbetjeve të rrezikshme
- Letër katrani
- Lëndë druri e trajtuar
- Lidhjet hekurudhore (traversat)
- Plehu organik
- Asfalti dhe produktet e asfaltit
- Karburantet dhe lubrifikantet
- Kontejnerët
- Mbetjet biomjekësore

15. Ne cdo rast, gjeneralitetet e personit/personave që realizojnë djegien, bashkë me kërkesat për leje dhe dokumentat shoqëruarë do të depozitohen pranë autoriteteve vendore dhe atyre të MZSH.

ANEKSI 3

Ligj Nr. ____/2022

Për Shpalljen e Moratoriumit Të Djegies se Tokave Bujqesore Në Republikën E Shqipërisë. Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi Qëllimi i këtij ligji është ndalimi i djegies së lëndës organike në tokat bujqësore, me qëllim parandalimin e dëmtimit të jetës, pronave, mjedisit dhe imazhit të vendit.

Neni 2

Objekti dhe fusha e veprimit

Ky ligj përcakton rregullat që do të zbatohen gjatë ndalimit të aktivitetit të djegies së tokave bujqësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Pezullimi i aktiviteteve të djegies së tokave bujqësore

1. Çdo lloj aktiviteti i cili çon në djegien e lëndës organike ose jo në tokat bujqësore përfshirë edhe vreshtat, pemtoret apo toka me bimësi tjetër, ndalohet.
2. Aktivitetet për djegien e tokave të cfarëdo lloj kategorie, nga periudha 1 Mars deri me 30 Nëntor të konsiderohen vepër penale.

Neni 4

Rastet përjashtimore

Djegia e tokave do të lejohet me akt të vecantë vetëm në ato rastate kur;

1. Shfaqen sëmundje që bëhen shkas për përhapjen e epidemive apo shtaktojnë dëmtime serioze në shëndetin e njeriut, produktet bujqësore dhe blegtorale;
2. Shfaqen dëmtues të cilët përbëjnë problem serioz për shëndetin e njeriut dhe të kafsheve, që rezultojnë në dëmtimin masiv të kulturave bujqësore, drurëve frutorë dhe plantacioneve të tjera.

Përjashtimi, i përcaktuar në pikën 1 dhe 2, të këtij neni, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për bujqësinë.

Neni 5

Afati i zbatimit Afati i zbatimit të këtij ligji është dhjetë vjet, nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 6

Sanksionet

1. Shkeljet e këtij ligji, që nuk konsiderohen vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
 - a) kur shkelja kryhet nga grupe të organizuara fermerësh, subjekti që e organizon dënohet me gjobë në masën 800 000 (tetëqind mijë) - 1 000 000 (një milion) lekë;

b) kur shkelësi është një individ, dënohet me gjobë në masën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) - 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

2. Në rastet e përsëritjes së shkeljes, nga subjektet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, vendoset si dënim plotësues edhe heqja e të drejtës së pronësisë apo përdorimit mbi tokën.

3. Shqyrtimi i kundërvajtjes bëhet nga inspektorati shtetëror përgjegjës për bujqësinë. Vendimi i dënimit, ankimi kundër tij dhe ekzekutimi i dënimeve me gjobë bëhen në përputhje me ligjin nr. 10433, date 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 7

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit

Ngarkohen ministri i Bujqësisë, ministri i Mjedisit dhe Turizmit, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Financave, dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve për zbatimin e këtij ligji.

Neni 8

Aktet nënligjore Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të këtij ligji.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.6.2016 Shpallur me dekretin nr. 9640, datë 14.6.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

KRYETAR

LINDITA NIKOLLA